

Raporti vjetor 2020

Shqipëri dhe Mali i Zi

Transformimi,
Sfida dhe
Angazhimi



Peace
Corps



Përmbajtja:

Mesazh nga ambasadorja eSHBA-së në Shqipëri.....	2
Mesazh nga ambasadorja eSHBA-së në Malin e Zi.....	3
Përshëndetje nga Drejtoresha Vendore.....	4
60 vite Korpusi i Paqes.....	7
Korpusi i Paqes në Shqipëri.....	8
Korpusi i Paqes në Malin e Zi.....	9
Evakuimi i vullnetarëve.....	10
Ku shërbyen vullnetarët në vitin 2020?.....	11
Ku jetuan vullnetarët në komunitetet e tyre në vitin 2020?.....	12
▪ <i>Pikat kulmore të qëndrimit në shtëpi.....</i>	13
Vështrimi i përgjithshëm i projekteve.....	14
▪ <i>Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve; Veprimtaritë dhe pikat kulmore të projektit.....</i>	15
▪ <i>Zhvillimi Organizativ; Veprimtaritë dhe pikat kulmore të projektit.....</i>	17
▪ <i>Mësimi i gjuhës angleze në Shqipëri; Veprimtaritë dhe pikat kulmore të projektit.....</i>	19
▪ <i>Mësimi i gjuhës angleze në Malin e Zi; Veprimtaritë dhe pikat kulmore të projektit.....</i>	21
Hartimi i masave zbutëse për COVID - 19; Zhvillimi i stafit; Tranzicioni i pozicioneve drejtuese....	23
Organizatat partnerë.....	25
Stafi ynë i trajnimit të para - shërbimit dhe stafi i përhershëm.....	26-27

Mesazh nga ambasadorja e SHBA - së në Shqipëri, Yuri Kim

Të nderuar miq, kolegë dhe partnerë,

Gjatë 23 viteve të qëndrimit të Korpusit të Paqes në Shqipëri, kemi qenë dëshmitarë të një pune jashtëzakonisht të mirë kur vullnetarët dhe homologët e tyre shqiptarë kanë bashkuar forcat për të kontribuar në ndryshime të qëndrueshme në komunitetet e tyre. Breza të tërë studentësh dhe të rinjsh shqiptarë në të gjithë vendin kanë mësuar anglisht dhe kanë zhvilluar aftësi për jetën falë Korpusit të Paqes, duke krijuar një trashëgimi që do të jetë përhërë pjesë e lidhjeve SHBA-Shqipëri. Më shumë se 900 vullnetarë dhe mijëra qytetarë shqiptarë dashamirës kanë trajtuar sfida komplekse dhe kanë krijuar marrëdhënie afatgjata gjatë këtij procesi. Vullnetarët kthehen në Shtetet e Bashkuara si ambasadorë të miqësisë shqiptaro-amerikane, pasi kanë përfituar perspektiva unike ndërkulturore si dhe drejtimin, gjuhën, dhe aftësitë teknike që u ofrojnë atyre një avantazh konkurruesh në ekonominë e ndërlidhur të ditëve të sotme.

Këto lidhje nuk janë zbehur kurrë, edhe pasi Korpusi i Paqes mori vendimin e vështirë në vitin 2020 për t'i rikthyer vullnetarët nga e gjithë bota në Shtetet e Bashkuara për shkak të pandemisë. Gjatë kësaj periudhe të veçantë kur nuk kishte vullnetarë në vend, Korpusi i Paqes Shqipëri ka punuar krah për krah me partnerët dhe palët e interesuara, duke reflektuar për securinë deri më sot dhe duke parashikuar se si duhet të zhvillohet vullnetarizmi dhe si të jetë i përgatitur për realitetin gjatë pandemisë. Nxënës, prindër, mësues, anëtarë të komunitetit dhe partnerë të qeverisë kanë shprehur nevojat e ndryshme në bazë të "normalitetit të ri" për trajtimin e të cilit, Korpusi i Paqes synon të ndihmojë tani. Shërbimi i vullnetarizmit do të vazhdojë të forcohet nga diversiteti dhe shumëlojshmëria, teksa Korpusi i Paqes mbështet kulturën e gjithëpërfshirjes që përqafon diversitetin – si atë nga Shtetet e Bashkuara, ashtu edhe atë që vjen nga nuancat e jashtëzakonshme të njerëzve dhe jetës në Shqipëri.

U bashkohem falënderimeve dhe përgëzimeve tuaja për stafin e Korpusit të Paqes dhe për partnerët e tyre shqiptarë teksha përgatisin terrenin për rikthimin e vullnetarëve të Korpusit të Paqes. Shpresoj t'i shoh sërisht vullnetarët e Korpusit të Paqes t'u shërbejnë komuniteteve shqiptare duke u përpjekur të japid ndihmë cilësore në fushat e arsimit në anglisht, zhvillimit organizativ dhe shëndetit dhe mirëqenies së të rinjve. Rikthimi i vullnetarëve të Korpusit të Paqes në Shqipëri do të jetë një moment historik për të gjithë ne dhe një kujtesë e partneritetit të fortë mes popullit amerikan dhe atij shqiptar.

Me respekt,

Yuri Kim

Ambasadore e SHBA-së në Republikën e Shqipërisë.



Mesazh nga ambasadorja e SHBA-së në Mal të Zi, Judy Rising Reinke

Të nderuar miq, partnerë dhe kolegë,

Gjatë vitit 2020 në jetët tona lanë mbresë shumë momente dramatike. Një që më ka mbetur në mend ishte momenti kur mësova se pandemia e COVID-19-ës kishte mbërritur në Malin e Zi. Pandemia sigurisht shkaktoi shumë shqetësimë për normalitetin e jetës në të gjithë globin. Një tjetër ndikim në Malin e Zi ishte fatkeqësisht ndryshimi i planeve për vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe komunitetet mikpritëse ndaj tyre. Si mund ta dini, në mars të vitit 2020, Korpusi i Paqes mori vendimin e vështirë për t'i kthyer të gjithë vullnetarët në Shtetet e Bashkuara dhe kjo përfshinte edhe 13 individë të angazhuar rishtas për të shërbyer në Malin e Zi, që sapo kishin përfunduar trajnimin e tyre.

Ndonëse ishte një masë paraprake për t'u ofruar siguri vullnetarëve tanë, ishte e trishtë t'i shihje të largoheshin pak pasi kishim pasur mundësinë t'i mirëprisnim personalisht. Vullnetarët më habitën me energjinë e tyre, të cilën ia dedikonin punës së të nxënët në gjuhën dhe kulturën e këtij vendi të bukur, si dhe duke përmirësuar aftësitë e tyre në mësimdhënien e gjuhës angleze. Grupi i parë i vullnetarëve arriti që herët të krijonte shumë lidhje me popullin malazez duke filluar nga familjet mikpritëse e deri te kolegët mësues. Gjatë takimit tonë të parë në fillim të marsit, grupi i angazhuar u shpreh se ndiheshin të nderuar të ishin pjesë të grüpuit të parë të vullnetarëve që shërbejnë në shkollat malazeze dhe përfaqësojnë fillimin e asaj që jam shumë e bindur se do të jetë një marrëdhënie e gjatë.

Që pas largimit të vullnetarëve, Korpusi i Paqes dhe partnerët e tyre malazezë kanë punuar shumë për të zhvilluar një proces gjithëpërfshirës për të mirëpritur vullnetarët në mënyrë të sigurt sa më parë të jetë e mundur. Jam mirënlohëse për punën dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit malazeze dhe shumë shkollave në të gjithë vendin, të cilat kanë treguar interes të madh për partneritetin me vullnetarët e Korpusit të Paqes. Jam shumë mirënlohëse për kujdesin dhe bujarinë e jashtëzakonshme që u kanë treguar familjet dhe komunitetet mikpritëse vullnetarëve. Në përgjigje të kontekstit të ndryshuar, Korpusi i Paqes ka rikonceptuar shërbimin për t'u përshtatur me nevojat malazeze dhe amerikane gjatë kësaj periudhe kritike. Për herë të dytë në histori, vullnetarët e Përgjigjes së Korpusit të Paqes janë futur në shërbim brenda vendit, duke vënë në përdorim aftësitë e tyre në qendrat e vaksinimit në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe jam shumë krenare që disa vullnetarë të Korpusit të Paqes nga Mali i Zi janë bashkuar me këtë nismë. Këta amerikanë po i përgjigjen thirrjes për të shërbyer dhe mezi po pres momentin kur këta dhe individë të tjera të përkushtuar do të mund të kthehen në Malin e Zi për të vazhduar ndërtimin e lidhjeve mes njerëzve midis vendeve tona.

Me respekt,

Judy Rising Reinke,
Ambasadore e SHBA-së në Malin e Zi



Mesazh nga Drejtoresha Vendore

Të dashur miq të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi,

Do të ishte një nënvorësim po të shprehesh se ka qenë një vit sfidues. Pandemia, ndryshimi i madh social dhe pasiguria në vijim e ka bërë jetën shumë të vështirë për të gjithë dhe traumatike për shumë të tjerë. U desh të bëheshin ndryshime të shpejta në jetën e të gjithëve. Pavarësisht të gjithë vështirësive, e kuptoj se kjo është koha dhe sfida për të cilën është krijuar Korpsi i Paqes. Korpsi i Paqes i Shteteve të Bashkuara është një mundësi shërbimi për individë të motivuar që duan të sjellin ndryshim duke u përfshirë me një komunitet jashtë vendit, duke punuar krah më krah me drejtuesit vendorë për të trajtuar sfidat më urgjente të brezit tonë. Për gjashtë dekada, vullnetarët e Korpusit të Paqes, përkrah drejtuesve të komuniteteve në 142 vende kanë treguar zgjuarsi, kreativitet dhe dëshirë për të zgjidhur sfida kritike.

Qasja e Korpusit të Paqes për zhvillimin përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve. Misioni është i trefishtë:

- Të ndihmojë popullsinë e shteteve të interesuara të përmbushin nevojat e tyre për burra dhe gra të trajnuar.
- Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të amerikanëve nga ana popujve që i shërbijnë.
- Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Tani, me mbi 20 vjet veprimitari në Shqipëri dhe një në Malin e Zi, mbi 900 vullnetarë të Korpusit të Paqes kanë shërbyer në qindra komunitete në këto shtete diversë dhe të bukur. Falënderoj çdo anëtar të komunitetit, homolog, zyrtar qeveritar, partner dhe anëtar të stafit që e bëri të mundur të gjithë këtë.



Drejtoresha Vendore e Korpusit të Paqes në Shqipëri dhe Malin e Zi dhe Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri, Evis Kushi

Mesazh nga Drejtoresha Vendore

Në vitin 2020, mbi 100 vullnetarë dinamikë iu përkushtuan integrimit në komunitet, zhvillimit të aftësive në gjuhën vendase dhe të kuptuarit të kulturave shqiptare dhe malazeze. Vullnetarët tonë e nisin rrugëtimin e tyre si të trajnuar, periudhë gjatë të cilës nisin një program intensiv 8 ose 10 javor që ofrojnë trajnim për gjuhën, mësimdhënie teknike dhe informacion ndërkulturor që është i rëndësishëm për integrimin dhe përshtatjen. Ky trajnim para shërbimit zhvillohet thuajse tërësisht në fshatra në zona rurale larg nga rajoni i kryeqytetit, gjatë të cilit të trajnuarit jetojnë me familjet mikpritëse.

Pasi përfundojnë me sukses trajnimin, të trajnuarit betohen të bëhen vullnetarë dhe shpërngulen në vendet e tyre të përhershme, pjesa më e madhe të cilave ndodhet në fshatra të vegjël. Pasi shkojnë në vend, vullnetarët bashkëpunojnë ngushtë me komunitetet e tyre, homologët dhe partnerët vendorë për të vlerësuar nevojat bazë dhe për të zhvilluar një plan pune të përbashkët në tri fushat e specialitetit:

- Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve
- Zhvillimi organizativ
- Të nxenit e gjuhës angleze

Për Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi, 2020 ishte një vit i veçantë transformimi, sfidash dhe angazhimi të vazhdueshëm për njerëzit të cilëve u shërbejmë.

Për sa i përket transformimit, viti 2020 solli disa zhvillime emocionuese, duke përfshirë lançimin e **Korpusit të Paqes në Malin e Zi**. Në janar të vitit 2020, të trajnuarit tanë në Malin e Zi iu bashkuan mbi 50 të trajnuarve në Shqipëri për trajnimin tremujor të para-shërbimit në dy shtete, në dy qendra të reja trajnimi në Lezhë, Shqipëri dhe Pecurice, Mali i Zi. Të 13 të trajnuarit përfunduan me sukses trajnimin e tyre dhe u betuan si vullnetarë të mësimdhënies së gjuhës angleze në mars të viti 2020. Ne jemi krenarë për klasën tonë të parë dhe falënderojmë të gjithë që ndihmuani me këtë arritje të konsiderueshme! Në veçanti, falë Drejtoreshës sonë Vendore, Kate Becker, dhe Drejtorit të Programimit dhe Trajnimit, Kyle Olsen, që patën vizionin dhe vullnetin për ta bërë këtë të mundur.

Unë, si Drejtoresha Vendore e ardhshme, isha shumë e entuziazmuar që mbërrita në Shqipëri dhe Mal të Zi me familjen time në nëntor të vitit 2020. Ka qenë një kënaqësi dhe nder të takoja kolegë kaq të përkushtuar dhe partnerë mbështetës qeveritarë, shumëpalësh dhe OJQ në këto dy vende shumë të bukura dhe me gjallëri. Ishte kënaqësia më e madhe të mirëprisja kolegë të rinj në ekip duke përfshirë, Jeffery Warner, Drejtori i Programit dhe Trajnimit.

Mesazh nga Drejtoresha Vendore

Për sa i përket sfidave, në mars të vitit 2020, Drejtoresha e Korpusit të Paqes Jody Olsen mori vendimin e vështirë për të evakuuar të gjithë vullnetarët në të gjithë botën, duke përfshirë vullnetarët në Shqipëri dhe Mal të Zi. Kjo për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë vullnetarëve për shkak të përhapjes së COVID-19-ës. Më 14 mars, të gjithë 108 vullnetarët e Korpusit të Paqes nga Shqipëria dhe Mali i Zi kishin marrë kujdes mjekësor dhe kishin shkuar të sigurt në shtëpi. Kjo përpjekje e madhe nga i gjithë ekipi i Korpusit të Paqes dhe Komuniteti i Ambasadës mundësoi kthimin e sigurt të vullnetarëve te familjet dhe miqtë e tyre në SHBA. FALEMINDERIT!

Që prej evakuimit angazhimi ynë i vazhdueshëm ndaj njerëzve të cilëve u shërbejmë nuk është luhatur kurrë. Që nga prilli i vitit 2020, ekipi i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi ka punuar për t'u përgatitur për kthimin e vullnetarëve të Korpusit të Paqes. Kjo ka përfshirë ***riorganizimin e shumë prej politikave dhe protokolleve*** të posteve tona për të marrë parasysh masat zbutëse dhe bashkëpunimin me agjencitë mikpritëse, familjet mikpritëse dhe homologët për të siguruar që këto protokolle të zbatohen në mënyrë efektive. Për më tepër, ekipi i Korpusit të Paqes ka kërkuar ***mënyra për të përdorur avantazhet e të nxenit në distancë për nevojat për trajnim të zyrës sonë***, që më parë zakonisht bëheshin personalisht. Për të arritur këtë qëllim, ekipi zhvilloi një sërë burimesh të të nxenit online për gjuhën, sigurinë, shëndetin dhe trajnimin teknik duke përdorur një platformë të quajtur Hapësira e të Nxenit. Gjithashtu, kërkuam ***të rekrutonim, punësonim dhe trajnonim më tej*** personelin kyç duke përfshirë personelin mjekësor shtesë në Malin e Zi dhe dy Zyrtarë Mjekësorë të Korpusit të Paqes.



Shpresojmë që vullnetarët tanë të kthehen sërisht në vend apo kushtet në të gjithë botën ta mundësojnë këtë. Ekipi i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi dhe unë po presim me padurim të vazhdojmë bashkëpunimin me ju dhe të gjithë partnerët për ta bërë këtë realitet.

Falënderime të përzemërtë për mbështetjen tuaj,

Megan Wilson

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi
Drejtoresha Vendore:

60 vite të misionit dhe qëllimeve të Korpusit të Paqes


Këtë vit ne përkujtojmë themelimin tonë, kur gjashtëdhjetë vite më parë në vitin 1961, presidenti John F. Kennedy themeloi Korpusin e Paqes për të nxitur mirëkuptim më të mirë dhe për të promovuar miqësinë ndërmjet amerikanëve dhe popujve të tjerë.

Misioni i Korpusit të Paqes është të promovojë pagen dhe miqësinë në botë duke përbushur tri objektiva:

1. Të ndihmojë popullsinë e shteteve të interesuara të përbushin nevojat e tyre për burra dhe gra të trajnuar.
2. Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të amerikanëve nga ana popujve që i shërbejnë.
3. Të ndihmojë në promovimin e një mirëkuptimi më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Për gjashtëdhjetë vite, vullnetarët e Korpusit të Paqes i kanë shërbyer çështjes së lirisë. Ata janë përfshirë në kulturat vendase, kanë mësuar shumë gjuhë në të gjithë botën, kanë përbushur nevojat e popujve për trajnim dhe si rrjedhojë kanë kontribuar në miqësinë midis amerikanëve dhe popujve të botës.

- Më shumë se 235,000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 142 shtete.



Korpusi i Paqes në Shqipëri

Në vitin 1991, qeveria Shqiptare ftoi SHBA-në të hapë një program të Korpusit të Paqes në vend. Grupi i parë i vullnetarëve mbërriti në Shqipëri në vitin 1992, të angazhuar për mësimdhënien e gjuhës angleze në shkolla te ciklit të dytë dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996 katër grupe të tjera vullnetarësh mbërriten për të dhënë mësim në anglisht, për të mbështetur zhvillimin e biznesit të vogël ose për të mbështetur menaxhimin e bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve përsigurinë e vullnetarëve.

Qeveria shqiptare ftoi Korpusin e Paqes të ri-hapë programin e tij në vitin 2002 dhe mori pjesë në një mission vlerësimi të zhvilluar nga Korpusi i Paqes. Bazuar në këtë vlerësim, anëtarët e parë të Korpusit të Paqes u rikthyen në mars të vitit 2003, ngritën një zyrë dhe ri-hapën programet.

Që nga shtatori i vitit 2003, vullnetarët kanë punuar me pushtetin lokal, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore në tre fusha:

- Mësimi i gjuhës angleze
- Shëndetësia, tanë duke u përqendruar në shëndetin dhe mirëgenien e të rinjeve
- Zhvillimi organizativ

Programi i Korpusit të Paqes është i pranishëm në Shqipëri me ftesë të qeverisë shqiptare dhe operon sipas një marrëveshjeje midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve me avantazhe reciproke dhe të bashkëpunimit.

Që nga shtatori i vitit 1992, mbi 900 vullnetarë kanë shërbyer në Shqipëri.



Korpusi i Paqes në Mal të Zi



Takimi i parë i trajnuarve të Korpusit të Paqes me familjet pritëse malazeze në vitin 2020

Trajnimi para shërbimit në Mal të Zi—Në janar të vitit 2020, grupei i parë i të trajnuarve mbërriti në Malin e Zi ku u prezantuan me popullin dhe kulturën malazeze.

Veprimtaritë—Menjëherë pas mbërritjes, të trajnuarit e Korpusit të Paqes nisen trajnimin para-shërbimit (TPSH), periudhë gjatë së cilës mësuan gjuhën malazeze, morën trajnim teknik dhe mësuan si të përm bushnin objektivat e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi.

Ndikimi— Ky trajnim i parë në Malin e Zi i hapi rrugën vullnetarëve të ardhshëm që të shërbenin në Malin e Zi si vullnetarë të arsimit në anglisht dhe u mundësoi komuniteteve malazeze të njihen nga afër me punën e Korpusit të Paqes në Malin e Zi.




2020: Evakuimi i vullnetarëve

- Për shkak të COVID-19, që më 16 mars 2020, Korpusi i Paqes i ktheu në shtëpi përkohësisht vullnetarët e Korpusit të Paqes nga e gjithë bota duke përfshirë ata që shërbën në Shqipëri dhe Malin e Zi. Prioriteti ynë është shëndeti, siguria dhe mirëqenia e vullnetarëve tanë. Ky vendim u nxit nga numri gjithnjë në rritje i kufizimeve të udhëtimit në të gjithë botën që ndikonte në mundësinë për të evakuuar më vonë vullnetarët nëse do të lindte nevoja.
- Ne u jemi mirënjoħes Qeverisë së Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe familjeve mikpritëse, partnerëve dhe komuniteteve pér kujdesin e jashtëzakonshëm dhe bujarinë kundrejt vullnetarëve tanë. Familjet dhe komunitetet mbështesin vullnetarët tanë çdo ditë duke punuar përkrah tyre, duke i bërë ata të ndihen sikur i përkasin këtij vendi, duke u kujdesur pér shëndetin e tyre dhe duke i mbështetur teksa mësojnë gjuhën dhe aftësitë gjatë përgatitjes pér shërbimin e tyre. Vullnetarët e Korpusit të Paqes i duan shumë familjet e tyre mikpritëse dhe investojnë shumë në komunitetet e tyre. Kjo marrëdhënie është shumë kuptimplotë si pér Korpusin e Paqes edhe pér vullnetarët e Korpusit të Paqes.
- Korpusi i Paqes është angazhuar në rikthimin e vullnetarëve tanë. Stafi ynë do të vazhdojë të bashkëpunojë me partnerët tanë dhe komunitetet tona pér rikthimin e vullnetarëve në Shqipëri dhe Mal të Zi apo kushtet në të gjithë botën ta mundësojnë këtë.



Përpara evakuimit, VKP Hailey mori një letër falënderimi pér kolegët e saj nga shkolla dhe nxënësit.



Ku shërbyen vullnetarët në vitin 2020?

- Në përgjithësi, vullnetarët shërbejnë në komunitete të vogla me akses në burime më të pakta. Vullnetarët përqendrohen në një nga tre sektorët:
 - Mësimin e gjuhës angleze;
 - Shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve; dhe
 - Zhvillimin organizativ
- Vullnetarët tonë krijojnë bashkëpunime me shkolla, bashki, ministri dhe OJQ dhe mund të përqendrohen në çështje të ndryshme përveç punës së tyre kryesore. Disa nga këto përfshijnë fuqizimin e grave, çështjet mjedisore, zhvillimin e turizmit dhe rritjen e qëndrueshmërisë së projekteve nëpërmjet pronësisë vendore.

Ku jetuan vullnetarët në komunitetet e tyre në vitin 2020?

Vullnetarët vendosen pranë familjeve mikpritëse gjatë periudhës së trajnimit para shërbimit për të paktën gjashtë muaj në qytetin ose fshatin ku shërbejnë për dy vite. Vullnetarët konsiderohen si anëtarë të rinj të familjes, por jo domosdoshërisht në të njëjtën mënyrë që trajtohen anëtarët e familjes në Shtetet e Bashkuara, pasijeta familjare në Shqipëri dhe Mal të Zi është ndryshe. Gjatë periudhës së përshtatjes nevojitet durim, mirëkuptim dhe fleksibilitet nga të dyja palët. Korpusi i Paqes kërkon familje mikpritëse që mund t'i ndihmojnë vullnetarët të kuptojnë traditat dhe normat e komunitetit në të cilin jetojnë. Ne nuk presim që familjet mikpritëse të ndryshojnë zakonet e tyre apo të përshtaten me vlerat amerikane - qëllimi ynë është respekti dhe mirëkuptimi i dyanshëm.

Në mars të vitit 2020, një anketë u kërkoi vullnetarëve të përshkruanin përvojën e tyre gjatë jetesës me një familje mikpritëse në Shqipëri. Vullnetarët u shprehën se familjet i ndihmuani të përmirësojnë aftësitë dhe njohuritë në shumë fusha: ndërtimin e marrëdhënieve të mira, rolet gjinore në komunitet, si të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm në komunitetin e tyre, si të aksesojnë transportin publik dhe shumë më shumë - të gjitha aftësi shumë të rëndësishme për jetën!



I trajnuari i Korpusit të Paqes, Michael, duke luajtur shah me familjen ku po qëndronte në Malin e Zi.

68%

e vullnetarëve të anketuar u shprehën se qëndrimin me një familje ishte një mundësi shumë e mirë për t'u lidhur me komunitetin.

76%

ranë dakord me faktin se qëndrimi me një familje i ndihmoi të mësonin dhe praktikonin gjuhën.

Krenaria është të marrësh më pak seç të duhet; bujaria është të japësh më shumë seç mundesh Shqiptarët janë njerëz shumë krenarë dhe bujarë

Është ora 7 e darkës dhe unë sapo u ktheva në shtëpi. Mësimi mbaroi në orën 4:30 dhe më pas shkuam në një kafene për t'u çlodhur dhe më pas dolëm për të eksploruar qytetin. Mamaja mikpritëse më thotë se darka do të jetë gati për gjysmë ore dhe duke qenë se isha i sfilitur, i lodhur dhe kisha shumë ftohtë mora kohën për t'u çlodhur dhe për të lexuar. Kur u ula në tavolinë u shokova nga sa shumë ushqim kishte. Familja e tyre ka katër pjesëtarë, dhe unë pesë, por ka mjartueshëm ushqim për tetë ose nëntë njerëz dhe mjartueshëm bukë sa për tri vakte. I pyes nëse do të ketë të ftuar dhe të hutuar më thonë që jo dhe më pyesin mos kam ftuar unë dikë. Edhe unë i them jo, por se e mendova këtë duke parë sa shumë ushqim ka. Më pyesin nëse nuk më pëlqen ushqimi. I them që më pëlqen, por nuk do të mund të haja kurrë kaq shumë në për një ditë, le më për një vakt. Ata qeshin dhe më thonë se mund të ha sa të dua. Rreth një orë më vonë e kam fshirë pjatën time. Teksa flas me babanë mikpritës për biznesin e tij dhe filmat me arte marciale (atij i pëlqen shumë Jet Lee dhe Jackie Chan), mamaja mikpritëse me hedh sërisht ushqim në pjatë.

E shoh dhe i them "nuk dua më"

Ajo më shikon, më buzëqesh dhe thotë "edhe pak."

I buzëqesh dhe i them "Jo faleminderit. U ngopa".

Ajo më thotë "S'ka gjë, mos ki turp"

I them "Nuk jam i turpshëm, vetëm nuk dua më"

"jo, vërtetë, nuk ka problem," ngul këmbë ajo.

"jo, është një problem, sepse nuk dua më." Ia kthej unë.

Më në fund ajo heq dorë. Shoh rreth e përqark tavolinës dhe të gjithë janë të shokuar nga sa "i pasjellshëm" u tregova. M'u desh t'i shpjegoja se në Amerikë nuk e kemi problem të marrim sa ushqim të duam. Kur jemi ngopur e themi dhe e kemi me të vërtetë. Nëse duam më shumë, kërkojmë më shumë me kënaqësi.

Më vonë mësova se në kulturën shqiptare luhet një lojë e vogël: Kur dikush të ofron ushqim, fillimisht duhet ta refuzosh. Ata të ofrojnë sërisht. Ti thua jo sërisht. Më pas ata ngulin këmbë. ATËHERË, ti thua po. Kjo është loja që ajo po luante me mua, por unë s'po luaja asnjë lojë: Nuk doja më ushqim. Nga vullnetari i Korpusit të Paqes, Ari.



Vullnetarët e Korpusit të Paqes zbulojnë gatime të reja të preferuara, teksha ndajnë gatime shqiptare me familjet mikpritëse.

Transformimi, Sfida dhe Angazhimi: Vështrimi i përgjithshëm i projekteve

Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve

Qëllimi i projektit

Fëmijët dhe të rinjtë në moshë shkollore janë të informuar dhe të fuqizuar për të pasur një jetë të shëndetshme dhe në mënyrë efektive të bëhen të rritur produktivë dhe të angazhuar.

Projekti shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve mbështet fëmijët e moshave 5 -19 vjeç dhe të rinj që të kenë jetë të shëndetshme dhe që të bëhen të rritur produktivë dhe të angazhuar. Vullnetarët në këtë projekt janë vendosur në shkolla për të lehtësuar edukimin shëndetësor dhe fizik, në përputhje me kurrikulen kombëtare për shëndetësinë. Jashtë klasës, vullnetarët koordinojnë veprimtaritë jashtë kurrikulare dhe kampet duke u përqendruar te shëndeti dhe mirëqenia.

Zhvillimi organizativ

Qëllimi i projektit

Fuqizimi i komuniteteve, organizatave dhe individëve shqiptarë për të menaxhuar në mënyrë efikase zhvillimin e komunitetit.

Projekti i zhvillimit organizativ synon të forcojë kapacitetet organizuese në nivelin vendor. Vullnetarëve në këtë projekt i është caktuar të punojnë përkrah agjencive qeveritare dhe organizatave të bazuara në komunitet që të shtojnë gradualisht kapacitetet e tyre për të menaxhuar në mënyrë efikase përpjekjet për zhvillimin e komunitetit. Vullnetarët promovojnë qasjet e bazuara në asete për zhvillimin e komunitetit, angazhimin e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe rrjetëzimit midis palëve të interesuara.

Mësimi i gjuhës angleze

Qëllimi i projektit

Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe të nxenit në gjuhën angleze

Nëpërmjet punës së vullnetarëve të tij të bazuar në shkollë, programi TEFL mbështet përvetësimin e gjuhës nga nxënësit dhe zhvillimin profesional të mësuesve të anglishtes nëpërmjet pëmirësimit të zotërimit të gjuhës dhe metodologjisë së mësimdhënies në linjë me mësimdhënies e gjuhës. Vullnetarët e TEFL jepin mësim të gjuhës angleze me mësues të gjuhës angleze dhe koordinojnë klubet, kampet dhe veprimtaritë e tjera jashtë kurrikulare me qëllim zhvillimin e drejtimit të të rinjve dhe aftësitet për jetën.




Mësuese vullnetare e Korpusit të Paqes dhe homologia e saj shqiptare

Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve (SHMR) në Shqipëri

ESH – Projekti për Shëndetin dhe Mirëqenien e të Rinjve

Qëllimi i projektit: Fëmijët dhe të rinjtë në moshë shkolllore janë të informuar dhe të fuqizuar për të pasur një jetë të shëndetshme që të bëhen të rritur produktivë dhe të angazhuar.



Shëndeti i të rinjve dhe kurrikula kombëtare e ministrisë të arsimit për mirëqenien - në vitin 2020, Korpusi i Paqes Shqipëri kanë nisur procesin e rishikimit të një projekti në kuadrin logjik të projektit, një kuadër për planifikimin e projektit. Rishikimi i projektit u hartua për të mbështetur edukimin seksual gjithëpërfshirës dhe aftësitë për jetën dhe "Plani i veprimit për promovimin shëndetësor" të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, teksa ndjezin udhëzimet e Korpusit të Paqes në Uashington.

Veprimtaritë – Procesi i rishikimit të projektit kërkon një analizë të hollësishme të Strategjive dhe Politikave të Qeverisë Shqiptare dhe nevojat dhe prioritetet e komunitetit duke u përqendruar në Arsimin dhe promovimin e shëndetësisë. Shumë burime dhe të dhëna statistikore u konsultuan gjatë procesit për të arritur një mirëkuptim më të thellë të arsimimit të të rinje në shkolla dhe në çfarë shkalle i mundëson të rinje të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për jetën për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të shëndetshme në jetë.

Ndikimi – Projekti i rishikuar për shëndetësinë do të mbështesë fëmijët dhe të rinjtë (mosha 5-18 vjeç) të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për jetën dhe vendime përgjegjshme dhe të shëndetshme si dhe të marrin vendime që do të ndikojnë jetët e tyre dhe të atyre përreth. Vullnetarët dhe homologët e tyre do të fuqizojnë të rinjtë me aftësitë e nevojshme për jetën dhe strategjitë për të mbështetur shëndetin emocional dhe fizik dhe për të promovuar praktika të barazisë gjinore nëpërmjet veprimtarive si kampe, klube pas shkollës, sporte, kolegët arsimtarë dhe grupet e mbështetjes.

1130

Përftues janë trajnuar nga vullnetarë dhe homologët e tyre në kampe dhe klube mbi zhvillimin personal dhe profesional , aftësitë për jetën dhe drejtimin.

1839

Individë janë prekur nëpërmjet trajnimeve në grup mbi shëndetin seksual dhe atë riprodhues dhe metodat kontraceptive moderne .

Pika kulmore e projektit SHMR

Klubet GLOW

Përpara se vullnetarët të evakuoheshin, Neda shërbeu si vullnetarja për edukimin shëndetësor në Tropojë dhe nisi klubin e parë GLOW (Girls Leading Our World - Vajzat që drejtojnë botën tonë) në qytetin mikpritës, duke filluar me shtatë anëtarë.

Veprimtaritë – GLOW u drejtua nga Neda në pozicionin e këshilltares vullnetare së bashku me Drejtoreshën shqiptare të klubit (një e rritur) dhe drejtuese të të rinje që morën funksionet e presidents së klubit, zëvendës presidentes, arkëtares dhe historianes. Ata ftuan folës dhe modele për t'u ndjekur nga komuniteti për të ofruar shërbime dhe drejtuar diskutimet gjatë takimeve. Temat përfshinin: udhëheqjen, punën në ekip, motërsinë, motivimin, fuqizimin, sipërmarrjen, zhvillimin e karrierës, mësimet në anglisht, stilet e shëndetshme të jetës, zbulimin personal, çështjet gjinore, reflektimet personale dhe tema të tjera të rëndësishme për ndërgjegjësimin për gratë dhe vajzat.

Ndikimi – GLOW është një program i vazhdueshëm që ka bërë bashkë mbi 32 vajza tropojane të moshës 14 - 18 vjeç për përvoja javore të drejtim. Pothuajse një vit pas evakuimit të VKP-ve, Klubi GLOW i Bajram Currit vazhdon misionin e tij për të fuqizuar dhe ngritur kapacitetet e vajzave në Tropojë. Ato janë të angazhuara dhe të etura për të sjellë ndryshime konstruktive në komunitetet e tyre, për shembull duke kontribuar në pastrimin e mjedisit, klubet e librit dhe nismat e ndërgjegjësimit për shëndetin mendor. Neda pati mundësi t'i mbështeste në distancë dhe të vazhdonte t'i motivonte këto drejtuese të mrekullueshme.



Fotoja e parë sipër është nga klubi i librit GLOW 'Përtej kopertinës' dhe e dyta është nga festimet e Ditës së Falënderimeve.

Zhvillimi organizativ (ZHO) në Shqipëri

Zhvillimi organizativ - Qëllimi i projektit

Fuqizimi i komuniteteve, organizatave dhe individëve shqiptarë për të menaxhuar në mënyrë të efektshme zhvillimin e komunitet.

Veprimtaritë—Pas evakuimit të vitit 2020 të vullnetarëve, stafi i Korpusit të Paqes vazhdoi të ruante komunikimin me partnerët për të ruajtur interesin, shkëmbyer informacion dhe treguar mbështetje dhe empati, veçanërisht për organizatat që ishin në linjën e parë të përgjigjes ndaj COVID-it si bashkitë dhe OJQ-të.

Stafi i ZHO-së mësoi se partnerët vazhdojnë të janë shumë entuziastë që VKP-të do të kthehen dhe janë të aftë të artikulojnë ndikimin që vullnetarët kanë pasur në organizatat dhe komunitetet e tyre. Stafi mësoi që kishte shumë raste të bashkëpunimi ku ish-vullnetarët vazhdonin të mbështesin organizatat në distancë. Disa shembuj përfshijë: Përgjigja ndaj situatës së COVID-it (Pogradec, Belsh), hartimi i projekteve (Krujë), mirëmbajtja e faqeve të internetit (Konispol), mbështetja e veprimtarive të zhvillimit të të rinjve (Tropojë) dhe finalizimi i projekteve që kishin mbetur pa përfunduar (Rubik).


Ndikimi— U organizuan një sërë telefonatash në ZOOM me përfaqësuesit e bashkive dhe OJQ-ve për të vlerësuar gatishmërinë e organizatave tonë partnere për rikthimin e vullnetarëve, adresimin e prioriteteve ose nevojave të reja dhe për të mësuar çfarë masash janë marrë në nivel vendor për sigurinë shëndetësore.

152

Ofrohet e shërbimeve u aftësuan dhe trajnuan në fushat e ofrimit të shërbimit, advokimit, promovimit të turizmit dhe zhvillimit të të rinjve.

1554

Individë të angazhuar në ndërtimin e shoqërisë civile, udhëheqje, aftësi profesionale, të nxënët e shërbimeve, punën vullnetare dhe aftësi advokuese.



Vullnetarët, Cole dhe Callum kanë punuar për të përmirësuar potencialin turistik në dy vende (Konispol dhe Finiq), ku KP punoi për herën e parë.

Pika kulmore e projektit ZHO: Promovimi i turizmit

Bashkëpunimi i vullnetarit të Korpusit të Paqes Ryan dhe zyrës së zhvillimit të turizmit dhe agrobiznesit në bashkinë Fushë Arrëz ishte shumë i suksesshëm.

Veprimtaritë — Edhe pasi shërbimi i Ryan-it përfundoi në mars të vitit 2020, projekti “Tavolinat Turistike” që ai lançoi së bashku me homologët e tij ka vazhduar. Kjo përfshin edhe projektin e vendosjes së piketave në shtigjet malore në fshatin Kryezi, ku dhe vendosën shenjimin edhe për shtegun Aliaj, Kalipjetër. Ky mbetet një nga projektet më të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në zonë, sepse u lejon turistëve që të navigojnë dhe bëjnë ecje në mal në rajon në mënyrë të sigurtë.

Duhet të përfshijmë edhe projektin “Kantina e Verës” në bashkëpunim me Agro Puka dhe gratë fermere të Kryeziut. Projekti vazhdon të sjellë rezultate pozitive dhe ka ndikuar në përmirësimin e situatës socio-ekonomike vendore, veçanërisht për gratë fermere të përfshira në projekt. Që me ngritjen e kësaj kantine, bashkia dhe komuniteti kanë ndihmuar me promovimin e produkteve të verës, rakisë dhe produkte të tjera kryesisht nga fermeret e zonës, duke i siguruar atyre një treg për shitje.

Ndikimi — Korpusi i Paqes është krenar kur sheh se puna e qëndrueshme e vullnetarëve vazhdon edhe pasi vullnetarët janë larguar nga vendi. Korpusi i Paqes mezi pret të mirëpresë sërisht vullnetarët sa po kushtet në të gjithë botën ta mundësojnë këtë.



Vullnetari i Korpusit të Paqes, Ryan, gjatë projektit të piketimit të shtigjeve malore

Mësimi i gjuhës angleze në Shqipëri

Projekti i mësimit të gjuhës angleze – Qëllimi i projektit

Zhvillimi i aftësive të mësimdhënies dhe të nxënësit në gjuhën angleze

Veprimtaritë – në muajt e fundit, stafi ynë i mësimdhënies së gjuhës angleze është lidhur me mbi 50 shkolla në të gjithë Shqipërinë. Ndonëse vullnetarët u evokuan në mars 2020 për shkak të pandemisë, stafi dhe vullnetarët e evokuar vazhduan bashkëpunimin dhe patën mundësinë të mbështesin dhe përfundojnë në mënyrë virtuale disa nga projektet që kishin nisur që më parë. Për më tepër, stafi përdori këtë mundësi për t'u lidhur me mbi 120 mësues dhe drejtorë shkollash për të eksploruar se si mund të thellojmë ndikimin e bashkëpunimit tonë.

Në dhjetor të vitit 2020 në takim me Ministren e Arsimit, Drejtoreshë Vendore së bashku me stafin e Korpusit të Paqes ranë dakord për t'i dhënë përparësi bashkëpunimit tonë duke marrë në konsideratë situatën e COVID-19. Korpsi i Paqes është duke punuar për të adresuar prioritetet e ministrisë për sa i përket mbështetjes së mësuesve dhe nxënësve dhe nga vullnetarët pritet që të kenë sukses në mjeshtirës së ri të mësimdhënies.

Ndikimi – Mësuesit shqiptarë do të jenë të përgatitur më mirë për t'u përballur me sfidat në situatën e COVID-19.



Bibliotekë shkolle e ndërtuar nga vullnetarët e Korpusit të Paqes.


- 275 Mësues u angazhuan në mësimdhënie dhe planifikim të përbashkët, në krijimin e burimeve, krijimin klasavëme material burimore dhe bibliotekave nga tetori i vitit 2019 deri në mars të vitit 2020.
- 9153 Nxënësit mësuan anglisht në klasë dhe rritën pjesëmarrjen e tyre në veprimtaritë jashtë kurrikulare nga tetori i vitit 2019 deri në mars 2020.

Pika kulmore e projektit MGJA: Mësimdhënia vazhdon edhe pas largimit

Që kur Natalia ka përfunduar shërbimin e saj me Korpusin e Paqes Shqipëri, ajo ka vazhduar partneritetin kuptimplotë të vendosur me kolegen e saj shqiptare dhe mësimdhënien e përbashkët për nxënësit e tyre.

Veprimtaritë – Natalia ka shfytëzuar mundësinë për të vazhduar lidhjen me nxënësit e saj shqiptarë dhe vazhdon të mbështesë klasat e saj nga SHBA-ja nëpërmjet bashkëpunimit të shpeshtë me mikën e saj dhe kolegen mësuese. Si shumë mësues gjatë këtij viti sfidues, Lavdia, mësuesja e gjuhës angleze me të cilën Natalia punonte ishte shumë e zënë me mësimdhënien online. Mësimdhënia nëpërmjet videove dhe burimeve online nuk është e thjeshtë, por mësuesja shqiptare dhe mësuesja amerikane kanë zhvilluar një bashkëpunim ‘virtual’. Lavdia përqendrohet kryesisht në zhvillimin e videove dhe shpjegimin e gramatikës dhe fjalorit, ndërsa Natalia krijon skedarët audio shtesë në të cilët lexon pasazhe dhe dialogë. Një nga nxënëset u shpreh se “aftësitë e saj të të dëgjuarit dhe kuptuarit janë përmirësuar” si rezultat i mësimit online dhe nxënësja u shpreh se e vlerëson mbështetjen e të dy mësueseve. Lavdia dhe Natalia kanë një miqësi dhe marrëdhënie pune shumë të ngushtë. Së fundmi, së bashku ato kanë rishikuar dhe konsultuar një video-projekt për Zyrën Vendore Arsimore.

Ndikimi – Ky projekt tregon se partneriteti i Lavdies dhe Natalias shkon përtej përfitimit vetëm për nxënësit dhe mbështet edhe mësuesit në rajon. Ato të dyja tregojnë ndikimin dhe vlerën e mësuesve të angazhuar dhe të shkëlqyer.



Mësueset Natalia nga SHBA dhe Lavdie nga Shqipëria mbështesin virtualisht nxënësit e tyre.

Mësimi i gjuhës angleze (MGJA) në Malin e Zi

Projekti i mësimit të gjuhës angleze në Malin e Zi

Qëllimi i projektit

Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe të nxënësit në gjuhën angleze

Veprimtaritë – Përpara pandemisë, Korpusi i Paqes zhvilloi një sërë mbledhjesh me shkollat, komunitetet dhe palët e ndryshme të interesit ku prezantuan programin e Korpusit të Paqes dhe potencialin e tij për ndikim të konsiderueshëm. Që nga evakuimi, ne kemi vazhduar diskutimet me partnerët tanë malazezë, mësuesit, drejtorët e shkollave, pjesëtarët e familjeve mikpritëse dhe palë të tjera të interesit.

Trembëdhjetë vullnetarë u vendosën pranë familjeve mikpritëse malazeze gjatë trajnimit para-shërbimit (TPSH), i cili u zhvillua pjesërisht në Peçurice, një fshat i vogël malazez. Vullnetarët kaluan dy muaj në një shkollë në fshat, ku edhe u zhvillua trajnimi i tyre. Për t'u përgatitur për shërbimin, ata studuan gjuhën vendase teksa mëson rreth kulturës malazeze, sistemit të tij mësimor, historinë, etj.

Ndikimi– Sipas familjeve mikpritëse gjatë trajnimit para shërbimit, drejtorit të shkollës, mësuesve dhe nxënësve në shkollën e fshatit, vullnetarët kanë sjellë gjallëri në fshat duke krijuar miqësi që do të zgjasin shumë!



Vullnetarët gjatë TPSH-së, duke mësuar gjuhën dhe kulturën, Peçurice, Mali i Zi, shkurt 2020.


- 107** Takime me shumë palë të interesit gjatë zhvillimit të sajtit, si drejtorë shkollash, mësuesit, familjet mikpritëse, zyrtarët vendas, anëtarët e komunitetit.
- 1070** Numri i përafërt i personave që janë takuar drejtpërdrejt me palët e interesit gjatë nëpërmjet zhvillimit të sajtit.
- 457** Telefonata pas-evakuimit me drejtorët e shkollave, mësuesit, familjet mikpritëse dhe palët e tjera të interesit.

Pika kulmore e projektit MGJA: Lidhjet e forta të krijuara dhe të ruajtura

Dina ishte motra mikpritëse malazeze e vullnetares Sage dhe një ishpërfituese e bursës FLEX. Ajo flet me dashamirësi për këtë përvøjë.

Veprimtari – “Sage, një vullnetare që kaloi pak kohë me ne arriti që shumë shpejt të bëhej pjesë e pandashme e familjes sonë. Si dikush që ka qenë në një situatë të ngjashme, kur jetoja me familjen time pritëse amerikane gjatë shkëmbimit, doja që ajo të ndihej komode dhe sikur ishte pjesë e familjes që në fillim. Gjithsesi, procesi i përshtatjes me Sage ishte kaq i thjeshtë dhe i këndshëm, sa pas vetëm një javë ndiheshim sikur kishte qenë me ne gjithë jetën. Duke qenë se jam rritur me vëllezër, gjithmonë kam dashur të kem një motër dhe gjatë dy muajve që Sage qëndroi këtu, çdo herë që kthehesha në shtëpi kisha po këtë ndjesi.”

Ndikimi – “Gjatë kohës së shkurtër që vullnetarët qëndruan me ne, ata arritën të sillnin gjallëri në vendin tonë dhe të inkurajonin njerëzit të njoinin kultura të reja. Ndonëse ka një komunitet të madh të diasporës sonë në Shtetet e Bashkuara, njerëzve nga qyteti ynë rrallë u jepet mundësia të njoinin kulturën amerikane, si rrjedhojë kjo ishte një mundësi e shkëlqyer. Gjithashtu, vullnetarët inkurajuan fëmijët e shkollës të ishin më të hapur, të praktikonin anglishten duke folur me ta dhe të mësojnë në mënyra jo konvencionale.”



Vullnetarja e Korpusit të Paqes Sage dhe motra mikpritëse malazeze Dina dhe gjyshja mikpritëse.

Transformimi, Sfida dhe Angazhimi

HARTIMI I MASAVE ZBUTËSE PËR COVID-19.

Për rikthimin e VKP-ve është shumë e rëndësishme që të punojmë ngushtësisht me partnerët tanë në Shqipëri dhe në Malin e Zi për t'u siguruar që të hartojmë plane të informuara për zbutjen e rreziqeve nga COVID-19. Në vitin 2020, jemi angazhuar fort në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës për të trajtuar rreziqet e lidhura me COVID-19.

Që në mars të vitit 2020, anëtarët e stafit të Shqipërisë dhe Malit të Zi filluan të punonin nga shtëpia. Nëse duhet të punojnë në zyrë, ata respektojnë të gjitha protokollet e nevojshme për zvogëlimin e rezikut në transmetimin e COVID-19.

Metoda të zbutjes së rezikut



ZHVILLIMI PROFESSIONAL I STAFIT

Në vitin 2020, të gjithë anëtarët e stafit morën pjesë në programe trajnimi, duke përfituar nga mbështetja e stafit të Korpusit të Paqes dhe nismat e të nxenit.

Anëtarët e stafit u inkurajuan nga Drejtoresha Vendore të zhvillonin dhe zbatonin një plan për zhvillimin profesional, duke përfshirë identifikimin e pesë objektivave të zhvillimit profesional 'SMART' dhe një të zhvillimit personal

Stafi ka planifikuar një sërë veprimtarish trajnimi online dhe seanca përrahjen e mendimeve të lidhura me strategjinë dhe aftësitë.

TRANZICIONET E POSTeve DREJTUESE

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi mirëpriti Drejtoreshën e re Vendore (DV) dhe Dreitorin e ri të Programit dhe Trajnimit (DPT). Ekipi i ri i drejtit të dëgjohet si një staf vazhdojnë të jenë të përqendruar në vlerat themelore të shërbimit tonë, cilësisë dhe ndikimit, mirëqenies së vullnetarëve dhe mbështetjes së kulturës së gjithëpërfshirjes, barazisë dhe diversitetit.

Do të donim të falënderonim ish DV-në Kate Becker dhe ish DPT-në Kyle Olsen që u larguan nga posti pas përfundimit të shërbimit të tyre. Ishte një kënaqësi për të gjithë vullnetarët, partnerët dhe stafin të punonte me kolegë kaq të përkushtuar.



Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi mirëpret stafin e ri në vitin 2020

MEGAN WILSON

Drejtoresha Vendore:

Megan Wilson është një drejtuese që njeh tri gjuhë me 20 vjet përvojë në zhvillimin ndërkombëtar, duke u përqendruar te shëndetësia dhe mjedisi.

Përvoja në zhvillim e Znj. Wilson filloi në një fshat të vogël në Guinea, ku si vullnetare e Korpusit të Paqes ajo jepte mësim matematikë dhe ku ndërtoi një bibliotekë komunitare. Kjo dashuri përfuqizimin e të tjerëve të përmirësonin jetët e tyre vazhdoi të rritjej gjatë detyrate të saj të mëparshme si ndihmëse në kongres, si pjesë e stafit të EPA, USAID dhe Departamentit të Shtetit dhe periudhës së punës në 'Population Services International', si Drejtoreshë Ekzekutive për anëtarin e rrjetit të PSI-së në Benin. Teksa menaxhonte një buxhet vjetor prej 8 milionë dollarë në Benin, ajo punonte me një ekip prej 100+ personash duke përfshirë vullnetarët e Korpusit të Paqes çdo vit për të përmirësuar shëndetin e personave në Benin. Megan iu bashkua Korpusit të Paqes nga Medentach, ku punoi për të zhvilluar partneritet novatore për të shtuar aksesin në ujin e pijshëm për gratë dhe fëmijët në të gjithë botën. Përpara se t'i bashkohej kolegëve në Shqipëri dhe Mal të Zi, ajo ishte Drejtoresha Vendore e Korpusit të Paqes në Gambia.

Znj. Wilson zotëron një diplomë master në Zhvillimin Ndërkombëtar nga Shkolla Woodrow Wilson për Çështjet Publike dhe Ndërkombëtare në Universitetin Princeton dhe një diplomë Bachelor në Kimi dhe Çështje Ndërkombëtare nga Universiteti i Kolorados. Përveç gjuhës angleze, Megan flet rrjedhshëm frëngjisht dhe holandisht, si dhe një përzierje të gjuhëve afrikane.

JEFFREY WARNER

Drejtori i Programimit dhe trajnimit

Me origjinë nga Dearborn, Miçigan, Jeffery Warner është i apasoniuar pas shërbimit që e solli në Bullgari në vitin 2007 si vullnetar i mësimdhënies në anglisht për Korpusin e Paqes. Gjatë tri viteve të shërbimit, Jeffery jepte mësim anglisht dhe drejtonte një sërë projekteve për arsimin në Kardzhali, Bullgari. Jeffery u rikthye në Bullgari pas përfundimit të studimeve për të shërbyer si vullnetar i Përgjigjes së Korpusit të Paqes në organizatën e apo krijuar 'Teach for Bulgari' (TFB) [Mësim për Bullgarinë].

Si rrjedhojë ai u bashkua ekipit të TFB-së me kohë të plotë, duke punuar në fushën e trajnimit dhe mbështetjes së mësuesve, që përfshinte zhvillimin profesional dhe personal të pjesëmarrësve në program.

Përvojat profesionale të Jeffery-it të kohëve të fundit përpara se t'i bashkohej Korpusit të Paqes përfshijnë 'Trust for Social Achievement' (TSA) [Besimi për arritje sociale], një fondacion i angazhuar zvogëlimit të varférësë dhe ngushtimit së hendeqeve në Bullgari, duke u përqendruar në komunitetin Rom. Jeffery ka shërbyer si Oficer i Vlerësimit për TSA-në nga viti 2019-2020. Në këtë rol Jeffery mbikëqyrte hartimet e vazhdueshme të projekteve të TSA-së, monitorimin dhe përpjekjet për vlerësim.

Jeffery ka një master në politika publike nga Shkolla Gerald R. Ford për Politikat Publike në Universitetin e Miçiganit, si dhe një diplomë bachelor në Histori (cum laude) nga Universiteti i Miçiganit Perëndimor.

Transformimi, Sfida dhe Angazhimi - Organizatat partnerë për vitin 2020

Organizata jo qeveritare (OJQ)	Organizata qeveritare dhe të pavarura																																	
<ul style="list-style-type: none"> • Agro-Puka • Fondacioni i Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore Shqiptare • Këshillat Amerikanë • Qendra ARKA-Shkodër • CSDC Durrës • Darien Book Aid • Shoqata e mësuesve të gjuhës angleze • UAF-Unioni i anglisht-folësve • Fondacioni Food Bank Albania • Friends of Albania • Mary Ward Loreto • New Bridges • Qendra Marrëdhëniet • Agjencia e Zhvillimit Rajonal-Korçë • Sidi Education • Terre des Hommes • Touristic Dibra • Water Charity • World Association of Girl Guides and Girl Scouts • World Central Kitchen • World Connect • World Vision • Qendra rinore —Vlorë 	<ul style="list-style-type: none"> • ASCAP (Agjencja e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - Shqipëri) • DPAP (Drejtoria e Përgjithshme i e Arsimit Parauniversitar - Shqipëri) • HAP (Projekti Shëndet për të Gjithë) • Instituti i Shëndetit Publik - Shqipëri • Ministria e Arsimit e Malit të Zi • Forumi MNE • Shoqata e mësuesve të gjuhës angleze në Mal të Zi • Ministrinë e Punëve të Jashtme Mal i Zi • Ministria e Punëve të Brendshme Mal i Zi • Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, Shqipëri • Projekti për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore • QSHA (Qendra për Shërbimet Arsimore) • Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) • Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë • Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar(USAID) • Ambasadat e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe Malin e Zi dhe American Corners • Universiteti i Shkodrës, departamenti i anglishtes • Universiteti i Tiranës, departamenti i anglishtes 																																	
Bashkitë	Drejtoritë Rjonale Arsimore dhe Zyrat e Arsimit																																	
<table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 33%;">• Berat</td> <td style="width: 33%;">• Kavajë</td> <td style="width: 33%;">• Lushnje</td> </tr> <tr> <td>• Bulqizë</td> <td>• Klos</td> <td>• Mirditë</td> </tr> <tr> <td>• Elbasan</td> <td>• Korçë</td> <td>• Përmet</td> </tr> <tr> <td>• Ersekë</td> <td>• Krujë</td> <td>• Roskovec</td> </tr> <tr> <td>• Fushë Arrëz</td> <td>• Kuçovë</td> <td>• Shijak</td> </tr> <tr> <td>• Gjirokastër</td> <td>• Librazhd</td> <td>• Dimal</td> </tr> </table>	• Berat	• Kavajë	• Lushnje	• Bulqizë	• Klos	• Mirditë	• Elbasan	• Korçë	• Përmet	• Ersekë	• Krujë	• Roskovec	• Fushë Arrëz	• Kuçovë	• Shijak	• Gjirokastër	• Librazhd	• Dimal	<table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 33%;">• Berat</td> <td style="width: 33%;">• Lezhë</td> <td style="width: 33%;">• Tropojë</td> </tr> <tr> <td>• Durrës</td> <td>• Lushnjë</td> <td>• Përmet</td> </tr> <tr> <td>• Fier</td> <td>• Mat</td> <td></td> </tr> <tr> <td>• Kajavë</td> <td>• Shkodër</td> <td></td> </tr> <tr> <td>• Korçë</td> <td>• Skrapar</td> <td></td> </tr> </table>	• Berat	• Lezhë	• Tropojë	• Durrës	• Lushnjë	• Përmet	• Fier	• Mat		• Kajavë	• Shkodër		• Korçë	• Skrapar	
• Berat	• Kavajë	• Lushnje																																
• Bulqizë	• Klos	• Mirditë																																
• Elbasan	• Korçë	• Përmet																																
• Ersekë	• Krujë	• Roskovec																																
• Fushë Arrëz	• Kuçovë	• Shijak																																
• Gjirokastër	• Librazhd	• Dimal																																
• Berat	• Lezhë	• Tropojë																																
• Durrës	• Lushnjë	• Përmet																																
• Fier	• Mat																																	
• Kajavë	• Shkodër																																	
• Korçë	• Skrapar																																	

Stafi ynë i trajnimit para shërbimit në vitin 2020

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi punësoi 22 persona për të qenë pjesë e stafit të përkohshëm që luan një rol vendimtar në trajnimin para shërbimit (TPSH) për të trajnuarit tanë. Këta individë janë të përkushtuar ndaj idealeve dhe misionit të Korpusit të Paqes po aq sa stafi ynë që punon me kohë të plotë. Ata janë pjesë e familjes sonë çdo vit, dhe kur TPSH mbaron e kemi të vështirë të përshëndetemi me ta. Ata i mësojnë të trajnuarve tonë një gjuhë e kulturë të re; aftësi teknike, si të jenë të sigurt dhe të shëndetshëm dhe i përgatisin për dy vitet e tyre të shërbimit si vullnetarë të Korpusit të Paqes. Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi është ky që është sot falë përpjekjeve të tyre.



Admir Gjoni
Aishe Tufa
Arben Brahimë
Armando John
Besarta Stafa
Brikena Marku
Doris Pavićecić
Emarilda Leti
Erion Kumuria
Etleva Sula
Griselda Marini
Jolanda Gjoni
Jolanda Hila
Ledion Veshi
Leonora Bibaj
Pashka Gjini
Rafaela Palushi
Rikela Fusha
Tiana Čović
Vjollca Merdani
Zamir Mero
Zerina Zeneli

Stafi ynë i përhershëm në vitin 2020

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mal i Zi është krenar që ka një staf të përkushtuar të përbërë nga amerikanë, shqiptarë dhe malazezë. Ekipi ynë përbëhet nga disa prej talenteve më të mira në të dyja vendet ku shërbejmë. Ekipi e ka fokusin të ndihmojë vullnetarët të arrijnë potencialin e tyre gjatë shërbimit. Ata janë të emocionuar për punën e tyre dhe që do të bëjnë diferençën për fëmijët, komunitetet dhe njerëzit në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky ekip është shembull për Korpusin e Paqes dhe vlerat që ne promovojmë. Ky është ekipi që është përgjegjës për punën e mirë që kemi bërë në Shqipëri që nga viti 1992, por gjithashtu edhe ekipi që iu kërkua të drejtonte dhe menaxhonte mundësinë e re për të shërbyer në Mal të Zi.

Agim Dyrnishi	Kate Becker
Arben Cako	Kyle Olsen
Arben Loci	Luka Bobicic
Ardjan Cobaj	Lumturi Piciri
Artenca Collaku	Marie
Besa Arapi	Aughenbaugh
Carmen Sheehan	Marjeta Zavalani
Darina Kaltani	Marsela Loci
Diana Djaloshi	Megan Wilson
Elsona Cupi	Mira Luca
Gentian Leka	Mirela Tahiraj
Geri Martiri	Monika Mukja
Ilir Memlikaj	Poleta Luga
Ilir Ziu	Qazim Hoxha
Iris Dollia	Rikela Fusha
Iva Sinani	Sara Gaçe
Ivana Delibasic	Suida Shima
Jeffery Warner	Ylli Cupi
Julian Pando	





Peace Corps

ALBANIA AND MONTENEGRO



Korpusi i Paqes në Shqipëri
Rr. Besnik Sykja, Ndërtesa 2
Apartmenti 1, Kutia postare
8180 Tiranë, Shqipëri

📞 +355 42 365 5033

Zyra e Korpusit të Paqes në
Mal të Zi Vaka Đurovića bb,
Podgorica, Mal i Zi

📞 +382 (0) 20674509

✉️ AL-information@peacecorps.gov

🌐 www.peacecorps.gov/albania/

🌐 www.peacecorps.gov/montenegro/

>f facebook.com/albania.peacecorps

f facebook.com/peacecorpsinmontenegro

-instagram [search for us via: @peacecorpsalbania](#)